

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Pg. 1

AMA-TAIEX, workshop 2-ditor për përafrimin e kuadrit ligjor të medias audiovizive me legjislacionin e Bashkimit European



Fq. 1

Krasniqi në Këshillin Kombëtar të Integritetit European: Lufta kundër piraterisë digjitale kërkon bashkëpunim institucional dhe ndërkombëtar

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X



Fq. 1

AMA organizon takimin e parë ndërinstitucional për ngritjen e Task Forcës kundër piraterisë digjitale dhe audiovizive


Në zbatim të rekomandimit të Këshillit Kombëtar të Integritetit European, Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi takimin e parë ndërinstitucional për ...

Krasniqi pret kryetaren e CRTDSA-së, forcohet bashkëpunimi institucional për sfidat e medias dhe shërbimeve digjitale

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), znj. Armela Krasniqi, mirëpriti Presidenten e Autoritetit për Radiotelevizionin dhe Shërbimet Digjitale të Qipros ...



Fq. 1



Fq. 1

AMA raporton platformën e paligjshme shqiperia.dev, Cloudflare e bllokoi menjëherë. Hiqet nga Google Play aplikacioni "One IPTV Player"

Platforma e paligjshme shqiperia.dev, e cila ritransmetonte pa autorizim përmbajtje të operatorëve audiovizivë me licencë ...

Krasniqi në Këshillin Kombëtar të Integritimit Europian: Lufta kundër piraterisë digjitale kërkon bashkëpunim institucional dhe ndërkombëtar

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, znj. Armela Krasniqi, mori pjesë në takimin periodik të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, i zhvilluar në Kuvendin e Shqipërisë. Në takim, ajo prezantoi qasjen dhe masat e ndërmarra nga AMA në luftën kundër piraterisë audiovizive. Krasniqi nënvizoi se ky fenomen përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për funksionimin e tregut audioviziv, cenon konkurrencën e ndershme dhe dëmton operatorët që investojnë në mënyrë të ligjshme në përmbajtje cilësore. [Lexo më shumë](#)



AMA-TAIEX, workshop 2-ditor për përafrimin e kuadrit ligjor të medias audiovizive me legjislacionin e Bashkimit Europian

Në kuadër të instrumentit TAIEX të Komisionit Europian, Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi në Tiranë workshop-in me temë: "Zhvillimi i kuadrit ligjor për median audiovizive në përputhje me Direktivën për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD) dhe Aktin Europian për Lirinë e Medias (EMFA)". Workshop-i synon të mbështesë Autoritetin e Mediave Audiovizive në zbatimin e ndryshimeve të fundit të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", si dhe në avancimin e mëtejshëm të përafrimit të Shqipërisë me kuadrin rregullator të Bashkimit Europian në fushën e mediave audiovizive. [Lexo më shumë](#)



AMA organizon takimin e parë ndërinstitucional për ngritjen e Task Forcës kundër piraterisë digjitale dhe audiovizive

Në zbatim të rekomandimit të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi takimin e parë ndërinstitucional për hartimin e Memorandumit të Bashkëpunimit për ngritjen dhe funksionimin e Task Forcës Kombëtare për luftën kundër piraterisë digjitale dhe audiovizive, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të transmetimit. Drafti i parë i Memorandumit është përgatitur nga grupi i punës i ngritur pranë AMA-së dhe u prezantua për diskutim me institucionet pjesëmarrëse.

[Lexo më shumë](#)

Krasniqi pret kryetaren e CRTDSA-së, forcohet bashkëpunimi institucional për sfidat e medias dhe shërbimeve digjitale



Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), znj. Armela Krasniqi, mirëpriti Presidenten e Autoritetit për Radiotelevizionin dhe Shërbimet Digjitale të Qipros (CRTDSA), znj. Rona Kassapi, si edhe Drejtoreshen e këtij autoriteti, znj. Irene Loizidou Nicolaidou, në një takim të zhvilluar në ambientet e AMA-së. Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimin e përvojave mbi sfidat e reja rregullatore në sektorin e medias audiovizive dhe shërbimeve digjitale.

[Lexo më shumë](#)



AMA raporton platformën e paligjshme shqiperia.dev, Cloudflare e bllokoi menjëherë. Hiqet nga Google Play aplikacioni "One IPTV Player"

Platforma e paligjshme shqiperia.dev, e cila ritransmetonte pa autorizim përmbajtje të operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare, përfshirë DigitAlb dhe Tring, është raportuar zyrtarisht nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Po kështu aplikacioni "One IPTV Player" është hequr nga Google Play Store pas një procesi verifikimi të kryer nga ekipet e inspektimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për shkak të shkeljes së të drejtave të transmetimit.

[Lexo më shumë](#)

AMA raporton në Kuvend për zbatimin e Rezolutës: Avancim në transparencë, monitorim, mbrojtje të fëmijëve dhe aksesueshmëri

AMA ka raportuar në Kuvend masat e ndërmarra nga institucioni në zbatim të katër rekomandimeve kryesore të Rezolutës për Raportin Vjetor të AMA-së. Krasniqi evidentoi rezultatet e arritura në përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e kapaciteteve monitoruese, mbrojtjen e fëmijëve dhe garantimin e aksesueshmërisë në shërbimet mediatike.

[Lexo më shumë](#)



Krasniqi merr pjesë në Mbledhjen e Pestë Plenare të Bordit European për Shërbimet Mediatike

Në Mbledhjen e Pestë Plenare të Bordit European për Shërbimet Mediatike mori pjesë edhe Kryetarja e AMA-së, znj. Armela Krasniqi.

Kryetarja e Bordit e hapi takimin me një përditësim mbi ecurinë e zbatimit të Programit të Punës së Bordit për vitin 2026, ndërsa znj. Renate Nikolay, Zëvendësdrejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë për Rrjetet e Komunikimit, Përbajtjen dhe Teknologjinë e Komisionit European, prezantoi zhvillimet më të fundit dhe prioritetet strategjike të Komisionit European në fushën e medias dhe shërbimeve digjitale.

[Lexo më shumë](#)

